



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1015/7 Prot

Tiranë, më 13.7.2022

VENDIM

Nr. 22, datë 13.7.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1015 Prot., datë 18.05.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Doganave” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës datë 19.04.2022, depozituar në adresën elektronike oligert.kume@dogana.gov.al ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/ dokumentacioni, si vijon:

1. *Kërkoj sasinë totale dalëse nga territori i Republikës së Shqipërisë të mallrave shqiptare si “druri” dhe “artikujve prej druri”, gjatë vitit 2020 dhe 2021, si dhe respektivisht, operatorët ekonomikë që i operojnë ato.*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 1015/1 Prot., datë 20.05.2022, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 27.05.2022, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “*Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka proceduar me rastin në datë 22.05.2022. Në përgjigjen e datës 22.05.2022, Autoriteti Publik ka bërë me dije në lidhje me kërkesën tuaj për informacion të depozituar në adresën oligert.kume@dogan.gov.al është bërë me dije nga Zyra e Komisionerit, i cili prej datës 19.04.2022 nuk ka patur akses dhe detyrën funksionale për trajtimin e çështjeve dhe si të tilla kanë qenë të bllokuara nga sistemi IT, i cili menaxhohet nga AKSH-i, institucion jashtë fushës së veprimtarisë së DP Doganave. Në lidhje me kërkesën tuaj, po ju dërgojmë bashkëlidhur informacionin e kërkuar. Në Tabela EX1 Eksporte Definitive, jemi përpjekur të definojmë gjetjet kryesore sipas sistemit tonë, sipas kodeve tarifore, pasi kërkesa juaj është e përgjithshme. Ju lutemi të bazoheni në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave për detajime më specifike në të ardhmen. <https://dogana.gov.al/dokument/3841/nomenklatura-2022>. Kërkesa juaj ka përfshirë (Seksioni IX Druri dhe Artikujt prej Druri; Qymyri i Drurit; Tapa dhe Artikujt prej Tape; Prodhimet prej Kashte, prej Asparto apo prej Materialeve të tjera Gërshetuese; Punët në Xunkth apo me Kallama. faqe 285 deri 297 - Kapitulli 44 dhe 45). Në lidhje me kërkesën për operatorët ekonomikë, ju bëjmë me dije se Tabela 2, përmban sasinë (m/kub), pesha neto (kg), vlera (lek) të kompanive, operatorëve ekonomikë (fizik dhe juridik) që kanë operuar me Degët Doganore të regjistruara në sistemin tonë doganor, të cilat kanë kryer veprime për vitet e kërkesës tuaj. Bazuar në Ligjin 102/2014 Kodi Doganor, neni 22 dhënia e informacionit nga autoritetet doganore - pika 2. Çdo person mund të kërkojë informacion lidhur me rregullat dhe zbatimin e procedurave doganore nga autoritetet doganore. Kodi Doganor kufizon komunikimin e informacioneve dhe mbrojtjen e të dhënave për subjektet tek palët e treta duke e kushtëzuar informacionin e marrë nga autoritetet doganore gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me operatorët ekonomikë, të një natyre konfidenciale, dhe si e tillë, mbulohet nga kushti i sekretit profesional. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në Kod, ky informacion nuk jepet nga autoritetet kompetente doganore, pa lejen e shprehur të personit/operatorit ekonomik ose autoritetit (gjykatës) që e ka dhënë atë”.*

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me pretendimin se nuk i është vendosur në dispozicion informacioni mbi emrat e operatorëve ekonomikë që operojnë në eksportimin e drurit dhe mallrave prej druri, ka vijuar ankimin, regjistruar pranë Zyrës së

Komisionerit me nr. 1015/3 Prot., datë 31.05.2022, duke kërkuar plotësimin e informacionit të kërkuar me argumentin se: *1. Kompania në fjalë (kushdo qoftë në tab. nr 2), e cila ka fituar të drejtën për të eksportuar materiale drusore, e ushtron këtë të drejtë nëpërmjet një license, kushtet e së cilës janë publike. Bie fjala, sa volum duhet; çfarë lloji të silvikulturës etj. 2. Për më tepër, kompania nuk e ushtron aktivitetin jashtë mbikqyrjes shtetërore. Ndonëse një kompani private, aktiviteti i saj mbikqyret nga shteti, pasi ky aktivitet mbështetet në administrimin e një pasurie publike (materiali drusor). Administrimi i pasurisë përcaktohet qartësisht (në mënyrë kufizuese dhe kushtore) në licensën publike që vetë shteti i ka lëshuar. 3. Nga ana tjetër, kompania ka detyrimin për t'iu përmbajtur kushteve të vëna në licencë. Madje, detyrimi shtrihet në vijim dhe përfshin raportime të pandërprera mbi aktivitetin e kompanisë në organet publike.*

Me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, si dhe evidentimin e personave përgjegjës të caktuar për trajtimin e kërkesës për informacion, me Urdhrin nr. 99, datë 22.06.2022, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke filluar nga data 24.06.2022.

Pranë Autoritetit Publik u depozitua urdhri i inspektimit administrativ, i cili u protokollua me nr. 12009 Prot., datë 26.06.2022.

Gjatë inspektimit të ushtruar, koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik mbajti të njëjtin qëndrim të shprehur më parë, duke refuzuar dhënien e informacionit me argumentin në vijim se: *“... në zbatim të ligjit nr. 17, datë 05.04.2018 “Për statistikat zyrtare”, DP Doganave grumbullon dhe përpunon të dhëna për lëvizjen e mallrave shqiptare dhe joshqiptare që hyjnë/dalin nga territori doganor me qëllim monitorimin apo zbatimin e politikave të veta zhvilluese, dhe bazuar në ligjin e sipërcituar, institucioni që ka të drejtë të publikojë dhe të furnizojë përdoruesit me të dhëna që do të përdoren për publikim, është INSTAT”.*

Në vijim, ankuesi me e-mail-in datë 28.06.2022, vijon t'i mbetet kërkesës së tij për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar *emrat e operatorëve ekonomikë që operojnë në eksportimin e drurit dhe mallrave prej druri.*

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”. Në kuptim të këtij parashikimi, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.*

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Në argumentin e parashtruar nga Autortieti Publik se bazuar në Ligjin 102/2014 Kodi Doganor, neni 22 dhënia e informacionit nga autoritetet doganore - pika 2. Çdo person mund të kërkojë informacion lidhur me rregullat dhe zbatimin e procedurave doganore nga autoritetet doganore. Kodi Doganor kufizon komunikimin e informacioneve dhe mbrojtjen e të dhënave për subjektet tek palët e treta duke e kushtëzuar informacionin e marrë nga autoritetet doganore gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me operatorët ekonomikë, të një natyre konfidenciale, dhe si e tillë, mbulohet nga kushti i sekretit profesional, Komisioneri e vlerëson të pabazuar në asnjë dispozitë ligjore apo provë që të legjitimojë kufizimin e dhënies se informacionit sipas nenit 17 të LDI.

Nga përgjigja e Autoritetit Publik konstatohet se, refuzimi i dhënies së informacionit është bërë mbi bazën e pikës 2 të nenit 22, paragrafi i parë i ligjit nr. 102, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nëpërmjet të cilit informacioni që autoritetet doganore marrin nga operatorët ekonomikë kufizohet për palët e treta, është i një natyre konfidenciale, duke përjashtuar a priori çdo individ që kërkon akses sipas dispozitave të LDI dhe për çdo kategori informacioni.

Në rastin konkret kërkesa për informacion lidhet me emrat operatorëve ekonomikë të cilët kanë në veprimtarinë e tyre eksportimin e drurit, produkteve të drurit, të cilat realizohen nëpërmjet shrytëzimit të pyjeve, të cilat bazuar në nenin 1 pika 1 e ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet” konsiderohen si: *“pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar”*, rrjedhimisht informacioni i kërkuar paraqet interes publik.

Ndërkohë, LDI rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Ky ligj, në nenin 17 të tij gjithashtu përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Në këto raste, Autoriteti Publik duhet të tregojë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që refuzohen, si dhe në bazë të cilës pikë të nenit 17 bëhet ky refuzim. Nga verifikimi i përgjigjes së Autoritetit Publik, nuk rezulton të jetë argumentuar refuzimi i dhënies së informacionit në përputhje me këtë nen.

Lidhur me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: *“...në zbatim të ligjit nr. 17, datë 05.04.2018 “Për statistikat zyrtare”, DP Doganave grumbullon dhe përpunon të dhëna për lëvizjen e mallrave shqiptare dhe joshqiptare që hyjnë/dalin nga territori doganor me qëllim monitorimin apo zbatimin e politikave të veta zhvilluese, dhe bazuar në ligjin e sipërcituar, institucioni që ka të drejtë të publikojë dhe të furnizojë*

përdoruesit me të dhëna që do të përdoren për publikim, është INSTAT”, Komisioneri vlerëson se ky argument nuk qëndron.

Sqarojmë se, bazuar në pikën 2 të nenit 12 të LDI “Autoriteti Publik, vetëm në rastet kur konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuar. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar. Në rastin konkret gjatë ushtrimit të inspektimit administrativ, Autoriteti Publik konfirmoi se e disponon informacionin e kërkuar, duke përmbushur kushtet sipas pikës 2 të nenit 2 të LDI, “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Gjithashtu, lidhur me emrat e operatorëve ekonomikë objekt i ankesës, sqarojmë se të dhënat e shoqërive tregtare nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe përpunimi i të dhënave të tyre nuk kufizohet nga Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës nr. 1015 Prot., datë 18.05.2022, të z. kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Doganave”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 19.04.2022, konkretisht: (“*emrat e operatorëve ekonomikë që operojnë në eksportimin e drurit dhe mallrave prej druri*”), brenda datës 20 . 7 .2022.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 13 . 7 .2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

